



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT - OPSTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATES PERQJITHSHME
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Dalës-Izlazna

Nr. 11-827
Br.

Data 01.08.2019
Datum

OBILIC-OBILIC

Në mbështetje të nenit 14.1 të Ligjit Për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-40 ,nenit 3 paragrafi 1.1 i Ligjit nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit ,nenit 4 .parag.1 të Udhëzimit Administrativ,nr.23/2010 Për Procedurat e Shpalljes së Programeve të Veçanta të Banimit si dhe Vendimit nr.I-68 të dt.25/04/2019 të Kuvendit të Komunës së Obiliqit ,Komisioni për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim në kompleksin kolektiv banesorë afarist **Hade** dhe **Hade 2** për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së ,familje të dëshmorëve,veteranëve ,invalidëve dhe viktimave të dhunës seksuale dhe personave të tjerë me nevoja të veçanta nga këto kategori ,përmes Programit të veçantë të banimit në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi ,jep banesa me qira joprofitabile dhe bën shpalljen publike të:

KONKURSIT

Komuna e Obiliqit ka siguruar program të veçantë të banimit, për familjet e kategorive të dala nga lufta e UÇK-së (për familjen e dëshmorit,invalidëve , veteranëve dhe viktimave të dhunës seksuale dhe personave tjerë me nevoja të veçanta nga këto kategori),e që nuk e kanë zgjedhur çështjen e banimit,duke ndarë banesa me qira joprofitabile për të krijuar kushte të përshtatshme për banim për këto kategori ,në kompleksin banesor Hade dhe Hade 2, të cilët mund të aplikojnë që nga data **01/08/2019**.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

1. Fotokopja e letërnjoftimit të parashtruesit të kërkesës
2. Çertifikata e lindjes për të gjithë anëtarët e familjes të parashtruesit të kërkesës
3. Çertifikata familjare,
4. Vërtetim(çertifikatën) e vendbanimit të përhershëm së paku 10 vite të jetë banor i komunës së Obiliqit,
5. Të dhënat për anëtarët e punësuar (nga punëdhënësi) dhe burimet e të hyrave të rregullta,
6. Vërtetimin nga MTI që personi kërkues dhe anëtarët e familjes së tij nuk kryejn aktivitet biznesor,
7. Vërtetim nga qendra e punësimit për të gjithë anëtarët e familjes të papunë,
8. Vërtetimin mbi dëshminë për familjen e dëshmorit të UÇK-së,invalidit të UÇK-së , Veteranit të UÇK-së dhe viktimave të dhunës seksuale,
9. Të dhënat mbi gjendjen shëndetësore të parashtruesit të kërkesës apo anëtarëve të familjes,të lëshuar nga ana institucioneve përgjegjëse shëndetësore –komisioneve profesionale,
10. Vërtetimin nga institucionet përgjegjëse shëndetësore –dëshminë për llojin e invaliditetit për parashtruesin e kërkesës ,



11. Dëshmi për statusin e banimit (jeton me qira, shtëpia e rrezikshme apo e papërshtatshme për banim etj.)
12. Dokumente tjera shtesë sipas rasteve tjera.

Numri i banesave që do të jepen në shfrytëzim

Kamuna ka në dispozicion **39 banesa** për këtë program të veçantë të banimit në objektin banesor Hade dhe Hade 2 të ndërtuar nga MMPH i cili ndodhet në Obiliq rr. "Washingtoni" me hyrjet nr.71,73,75,77 dhe 79.

Shpërndarja e aplikacioneve:

1. Organi kompetent komunal bënë shpërndarjen e aplikacioneve pa pagesë, në formë standarde, për të gjithë aplikuesit e interesuar dhe i njëjti merret në zyren pritëse në komunë kati i , çdo ditë pune prej orës 8.30 -16.00.
2. Kërkesa e plotësuar dhe dokumentacioni i nevojshëm dorëzohet dhe pranohet në komunë përmes zyrës pritëse çdo ditë pune.

Afati për aplikim:

1. Konkursi mbetet i hapur brenda 30(tridhjetë) ditëve nga dita e shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe web faqen e Komunës , duke filluar nga data **01/08/2019** deri më **31/08/2019** , ndërsa raporti dhe dokumentacioni i kompletuar i përcillet komisionit brenda 5(pesë)ditëve pas përfundimit të afatit 30 ditë.
2. Komisioni vlerësues për përzgjedhjen e familjeve bënë shqyrtimin e gjendjes së banimit dhe të dhënave tjera të nevojshme të aplikuesve brenda 30(tridhjetë)ditëve , ndërkaq brenda këtyre ditëve pasuese do të bëjë edhe vlerësimin dhe verifikimin në teren të parashtruesit të kërkesës.
3. Në rast se aplikuesi pas vlerësimit arrijnë numër të njëjtë të pikëve , atëherë përparësi do të kanë familjet me më shumë anëtarë(Neni 5,parag.4 i Udhëzimit administrativ nr.21/2010,për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit).
4. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit kohor,të pakompletuara dhe të paplotësuara me të dhënat e nevojshme nuk do të pranohen dhe do të konsiderohen të pavlefshme.

Dhënja e deklaratave në aplikacion

Nëse aplikuesi me vetëdije jep deklaratë të rrejshme apo paraqet dokumentacion të falsifikuar ,humb të drejtën për t'u kualifikuar si shfrytëzues i këtijë programi të banimit social të kategorive të dala nga lufta e UÇK-së.



Përfytyrja nga përfytyrja e banimit për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së

Përfytyrohen nga përfytyrja nga ky program familjet që kanë përfytyruar ndihmë në forma të të njëjtit nivel ose më të lartë se sa mund të përfytyrohet nga programet e veçanta të banimit.

Njoftimi për përfytyruesit

Komuna në tabelën e shpalljeve do të publikojë listën e familjeve të renditura sipas pikëve të fituara gjatë vlerësimit.

Afati për shfrytëzim

Përfytyruesve iu ndahet banesa në shfrytëzim në afat prej 1 (një) vit, me vlerësim të gjendjes ekonomike për çdo vit sipas dispozitave të Ligjit nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit.

E drejta për ankesë

Pas shpalljes së listës së familjeve të renditura sipas pikëve të fituara dhe kundër Vendimit të Komisionit Vlerësues, pala e paknaqur ka të drejtë ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditë në komisionin e ankesave pranë komunës, nga dita e pranimit të Vendimit.

Për informata shtesë kontaktoni Kryetarin e Komisionit z. Ibush Mjekiqi çdo ditë pune në nr. e tel **045 130 777**, nga ora 8.00-16.00

